

Tirane më 14.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “ Ndërhyrje rehabilituese e rrugëve të brendshme në PMLAT”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45233140-2 Punime rrugore**

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.279.400 (pesëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind presje dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Këshilli i Qarkut Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP nr.162 datë 23.12.2020, (i ndryshuar) si dhe në nenin 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 105.588 (njëqind e pesë mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 83 të LPP, (i ndryshuar) dhe në nenin 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të

parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- 2.1.1 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.2 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.3 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 45001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.4 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 39001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023) të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.2.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës objekt prokurimi pra jo me e vogël se vlera prej **2.111.760 (dymilion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë)** lekë lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar-Punë" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar) dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë 40 % të vlerës së fondit limit me xhiron minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) *Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;*
- b) *Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.*

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) *Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;*
- b) *Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.*

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare. Në nenin 19 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në tetor të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është procedurë e hapur nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës referuar nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 sa më sipër cituar.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9632/2006 "Per sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Kriteri sipas pikës 2.2.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitet 2023, 2024 sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), neni 5, pika "c", sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **2.639.700 (dymilion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntëmijë e shtatëqind) lekë pa TVSH** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **10.558.800 (dhjetëmilion e pesëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e tetëqind) lekë pa TVSH.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore per cdo situacion punimesh;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore
 - Çertifikatën e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar

kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), parashikohet se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor në funksion të kerkesës për të provuar përvojën e mëparshme të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit ka kërkuar që në rastin e paraqitjes së punëve të ngjashme me kontrata bashkëpunimi ku operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë një përqindje të caktuar dhe zëra specifikë të punës në tërësi ka kërkuar si dokumentacion shoqërues dhe ***kontratën e bashkëpunimit dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.*** Sqarojmë se për të vërtetuar faktin nëse ky operator ekonomik përmbush punët e ngjashme të kërkuara ky dokumentacion është i nevojshëm për autoritetin kontraktor. Në mbështetje të Nenit 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), aktet ligjore parashikojnë formën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik (kontrata e bashkëpunimit si dhe përcaktohen elementet konkrete që do të kryejë secili prej operatorëve ekonomik në bashkëpunim). Pra referuar këtij dokumentacioni përcaktohet saktësisht përqindja dhe elementët konkretë në zëra punimesh që operatori ekonomik ka marrë përsipër të realizojë në këtë kontratë duke i krijuar mundësi autoritetit kontraktor të verifikojë dhe vlerësojë nëse punimet e marra përsipër për tu realizuar në këtë kontratë janë të ngjashme me punimet e kontratës objekt prokurimi. Thënë kjo operatori ekonomik mund të plotësojë vlerën në përqindje të punës që kërkohet të realizohet por ndërkohe në kontratën e realizuar në bashkëpunim mund të mos ketë realizuar zëra të ngjashëm me kontratën objekt prokurimi duke mos provuar përvojën e suksesshme për punë të ngjashme.

Gjithashtu në kontratat e lidhura si nënkontraktor është kërkuar kontrata bazë ndërmjet kontraktorit dhe Autoritetit kontraktor si dhe miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga autoriteti kontraktor. Referuar Nenit 126 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 pika 3 përcaktohet se autoriteti kontraktor përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike miraton nënkontraktorët e mundshëm. Çdo nënkontraktim që nuk lidhet sipas kësaj dispozite nuk është i vlefshëm dhe nuk mund të vlerësohet nga autoriteti kontraktor si pune e ngjashme pasi bie ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Nisur nga këto dispozita ligjore autoriteti kontraktor ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin dhe vlerësimin e punëve të ngjashme të realizuara nëpërmjet kontratës me nënkontraktim.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NP-1 A Punime gërmimi në tokë;

NP-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale;

NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit;

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve

NS-18 A Punime topogjeodezike;

- sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe si dhe ne VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar).

Gjithashtu në mbështetje të Ligjit specifik nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), neni 8 përcaktohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose europiane... ”

Kategoritë për punimet e ndërtimit dhe niveli për çdo kategori punimesh zbatimi janë përcaktuar referuar zërave të preventivit të punimeve për këtë objekt, projektit të zbatimit si dhe në mbështetje te plote te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, (i ndryshuar).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	Punime germimi në tokë.	Punime germimi	A	0-20 milion
NP-4	Rrugë, autostrada,	Punime asfaltimi, punime shtresash, trotuar, mbushje	A	0-20 milion

	mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	me cakell e gur gurore ne trupin e rrugës		
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet per ndertimin e rruges kane impakt mjedisor në të gjithë gjatesine e saj	A	0-20 milion
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve	Prishje shtresa betoni	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike.	Punimet për ndërtimin e rrugës në të gjithë gjatesinë e saj paraqesin nevojën e punimeve topogjodezike	A	0-20 milion

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marre persiper sipas përqindjes së bashkepunimit. Në të gjitha rastet duhet të paraqitet deklarata e administratorit që drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), Neni 77, pika 1, gërma (c) si dhe pika 4 si dhe në mbështetje të nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar).

Eshtë kërkuar nëpërmjet këtij kriteri përcaktimi nga ana e operatorit ekonomik i drejtuesit teknik të punimeve si pjesë e personelit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për realizimin e kontratës pasi drejtuesi teknik i punimeve do të jetë personi përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës referuar pika 2.1 te kreut I te Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” si dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencë ose punonjës me kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt

të vertetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa (për 3 muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës) si më poshtë:

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier mjedisi 1 (një)
- Inxhinier topograf 1 (një)

Kriteri sipas pikës 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se disponojnë stafin inxhinierik sa më sipër.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, (i ndryshuar) ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, gërma (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”*

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, CV apo qënësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë janë operativë pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, topograf mjedisi dhe hidroteknik, elektrik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar punonjës të kualifikuar për realizimin e zërave të veçanta të punimeve, të pajisur me dëshmi kualifikimi, minimalisht si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës teknik ndërtimi;
- 4 (katër) punonjës karpentier;

- 2 (dy) punonjës Hekurkthyes;
- 2 (dy) punonjës Saldator;
- 3(tre) mekanik
- 4 (katër) punonjës Shofer/manovrator.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik (e vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror teknik dhe Diplomë/certifikate profesionale lëshuar nga Inspektoriati shtetëror teknik dhe industrial ose nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente

Kriteri sipas pikës 2.3.6 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit si dhe plotësimit të tabelës Tab.1 ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se disponojnë stafin teknik sa më sipër.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit manovrator emër/mbiemër, profil i punes, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmërisë së dëshmisë së aftësisë profesionale.

Argumentimi: Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me punimet që kërkohet të realizohen të cilat janë punime në trup të rrugës nga fillimi i punimeve deri në perfundim të tyre, punime gërmimi dhe mbushje punime shtresash, kanale, tombino, punime betoni, punime asfalto betoni etj. Gjithashtu ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjisllacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

Gjithashtu për realizimin e objektit është kërkuar përdorimi i mjeteve të rënda si eskavator, autobetonire, rrula etj. Me qëllim administrimin dhe përdorimin e makinerive të rënda për punimet e ndërtimit që do të realizohen nga ana e operatorit ekonomik, si dhe disiplinimin e përdorimit të këtyre mjeteve në zbatim të rregullave të sigurimit teknik detyrimisht kërkohet një staf teknik i specializuar. Gjithashtu për realizimin e objektit janë kërkuar automjetete vetshkarkuese përdorimi i të cilave referon kërkesën për shofere të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Numri i manovratorëve dhe shoferëve është kërkuar në përpjestim me numrin e mjeteve të rënda dhe kamioneve të kërkuar për realizimin me sukses të objektit. Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin

kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 6, gërma (c) ku specifikisht percaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 1 (një) punonjës i cili të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e Prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjet ndaj emergjencave dhe ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

Ne mbështetje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier” Autoriteti kontraktor duke vlerësuar të gjitha detyrat që mbulojnë këta punonjës për sigurinë në kantier ka gjykuar të jenë pjesë e stafit një punonjës i certifikuar pasi duhet të kryejë funksione të tilla të rëndësishme në kantier si mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve; caktojnë kufijtë dhe përgatitin zonën e stoqeve dhe të depozitimit të materialeve, në veçanti kur bëhet fjalë për lëndë dhe substanca të rrezikshme; përshtatin në funksion të zhvillimit të kantierit, të kohëzgjatjes efektive që duhet t'i jepet llojeve të ndryshme të punës ose fazave të punës; kryejnë bashkëpunimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të pavarur; kryejnë bashkëveprimin me aktivitetet që ndodhin në vendndodhje, brenda dhe në afërsi të kantierit.

Operatori ekonomik duke angazhuar punonjës të kualifikuar dhe me eksperience, vlerëson rëndësinë e projektit në fjalë rrit performancën e realizimit të projektit, rrit vlerën e investimit njerëzor në projekt, dhe në këtë mënyrë siguron suksesin e përbashkët.

2.3.8 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **22 (njëzet e dy) punonjës** për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përlllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përlllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore ne dite për cdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përlllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ. Nga përlllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve 60 ditë (2 muaj) duhen 3 (tre) inxhinier dhe 1 (teknik ndërtimi) si dhe 8 (tetë) punonjës administrativë sa më poshtë sqaruar në tabelë dhe argumentuar nga njësia e prokurimit:

Tabela e punonjësve:

NR.	Analiza	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	Ore pune/njesi	Ore pune/total
		1. PRISHJE				
1	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	25	18.8	470.00
2	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	91	18.8	1,710.80
		SHUMA 1:				2,180.80
		2. PUNIME DHEU				
3	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	25	5	125.00
4	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	91	5	455.00
		SHUMA 2:				580.00
		3. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME				

5	3.352	Mbushje me gur kave	m3	106	3.4	360.40
		SHUMA 3:				360.40
		4. PUNIME SHTRESASH				
6	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	15	0.28	4.20
7	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	71	0.075	5.33
8	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	91	0.34	30.94
		SHUMA 4:				40.47
		5. PUNIME SHTRESASH 2				
9	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	7	3.46	24.22
		SHUMA 5:				24.22
		6. PUNIME HEKUR BETONI				
10	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.5	60	30.00
		SHUMA 6:				30.00
		7. ANALIZA TEKNIKE				
11	3.226/1a	Shtrese asfaltobetoni me ngjyre me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	70	0.095	6.65
		SHUMA 7:				6.65
		8. PUNIME HEKUR BETONI 3				
12	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1.25	0.1	61.00
		SHUMA 8:				61.00
		9. ANALIZA JASHTE LISTE				
13	AnAN	Trotuar, me 10 cm beton, i stampuar (me forma sipas projektit)	m2	910	1.8	1,638.00
		SHUMA 9:				1,638.00
		SHUMA (1-9) ore pune				4,921.54

	Numri i punetoreve ne dite		615.19
	Numri i punetoreve per 60 dite pune (Sipas grafikut te punimeve)		10.25

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës 10-20 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
2	Kamionçine (kapaciteti mbajtës 3.5-5 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
3	Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
4	Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
5	Rrul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Ekskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Betonpompe		
8	Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera
9	Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
13	Bot uji 5000 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
14	Cekic pneumatik per thyerjen e betoneve	1 copë	Pronësi ose me qera
15	Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
16	Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronësise, dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerese, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese dhe fotot , ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase noteriale e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara do te angazhohen ne kete objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

- e) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Këshilli i Qarkut Tiranë (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës *bazuar në VKM nr.216, datë 13.04.2023* “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik mjetet dhe paisjet teknike Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatëse në lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive sa me siper është bere referuar zërave të punimeve reflektuar ne tabelë sa më poshtë:

TABELA E MAKINERIVE QË DUHEN PËR REALIZIMIN E PUNËVE NË OBJEKTIN: “Ndërrhyrje rehabilituese e rrugëve të brendshme në PMLAT”

NR.	Analiza	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	Makineri
		1. PRISHJE			
1	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	25	Matrapik
2	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	91	Matrapik
		SHUMA 1:			
		2. PUNIME DHEU			
3	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	25	Kamion

4	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	91	Kamion
		SHUMA 2:			
		3. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME			
5	3.352	Mbushje me gur kave	m3	106	
		SHUMA 3:			
		4. PUNIME SHITESASH			
6	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	15	Grejder, Rul me vibrim
7	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	71	Grejder, Rul me vibrim
8	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	91	Rul me vibrim, Eskavator,
		SHUMA 4:			
		5. PUNIME SHITESASH 2			
9	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	7	Vibrator
		SHUMA 5:			
		6. PUNIME HEKUR BETONI			
10	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.5	
		SHUMA 6:			
		7. ANALIZA TEKNIKE			
11	3.226/1a	Shtrese asfaltobetoni me ngjyre me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	70	Rul me kompresor, Autobitumatriçe, Asfaltoshtruese
		SHUMA 7:			
		8. PUNIME HEKUR BETONI 3			
12	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1.25	
		SHUMA 8:			
		9. ANALIZA JAShte LISTE			
13	AnAN	Trotuar, me 10 cm beton, i stampuar (me forma sipas projektit)	m2	910	
		SHUMA 9:			
		SHUMA (1-9) ore pune			
		Numri I punetoreve ne dite			
		Numri I punetoreve per 60 dite pune (Sipas grafikut te punimeve)			

Tabela e mësipërme është përgatitur në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Grafiku i punimeve të jetë sipas të gjithave zërave të punimeve. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuara nga projektuesi.